

AKT-THEMELIMI
i
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ Ylli i Detit ” sh.p.k.,

1. **z. Kreshnik Lekaj**, shtetas shqiptar, atësia Losh, amësia Age, lindur në Lezhë dhe banues në Lezhë, me adresë Shëngjin, Ishull Lezhë, Nr. 4503, i datëlindjes 03/08/1975, gjendja civile “ i martuar “ , person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftim ID nr. 036743237 dhe nr. Personal H50803024F.
2. **z. Ylli Deta**, shtetas shqiptar, atësia Pal, amësia Age, lindur në Milot dhe banues në Tiranë, me adresë : Rr. “ Halit Bega “, Pall. 131/1, shk. 2, Tiranë, gjendja civile “ i martuar “ , person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftim ID nr. 034851527 dhe nr. Personal I10115050H.

Në mbështetje të legjislacionit shqiptar në fuqi, respektivisht Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“, i azhornuar, Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit“, i azhornuar, sot, më datë **20 Qershor 2021 (dymijë e njëzetë e një)**, themelojmë Shoqërinë Tregtare : “ **Ylli i Detit** ” sh.p.k., si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me të dhënat si më poshtë vijon:

HYRJE

Ortakët kanë të drejta dhe detyrime që rrjedhin nga ushtrimi i veprimtarisë së shoqërisë. Qëllimi i këtij akti është themelimi i shoqërisë “~~MEDSTAR~~” sh.p.k., si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar .
Ylli i Detit

OBJEKTI

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “ **Ylli i Detit** ” shpk do të ushtrojë aktivitetin e saj në fushën e tregtimit me shumicë e pakicë të prodhimeve të detit; të gatimit të tij dhe shërbimit katering, Import – Eksport të prodhimeve detare si dhe të Pajisjeve, Makinerive që lidhen me këtë veprimtari. Gjithashtu, do të ushtroj çdo veprimtari tjetër që i shërben rritjes dhe zhvillimit të kësaj shoqërie në përputhje me legjislacionin shqiptar.

KOHËZGJATJA

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore : Pa afat, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

SELIA

- 5.1 Shoqëria e ka seline në: Ishull Shëngjin, Bashkia Lezhë, Zona Kadastrale 1987, Njësi në Katin 0, Seksioni " B ", **Lezhë**.
- 5.2 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj. Për këtë, ajo mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjenci në të gjithë territorin e R. Sh., si dhe jashtë saj, në përputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Shuma dhe pagesat e kapitalit themeltar

Kapitali themeltar i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të kufizuar "**Ylli i Detit**" sh.p.k, është 100.000 (njëqindmijë) lekë kontribut i ortakëve dhe është i ndarë në 2 (dy) kuota. Ortakët marrin në pronësi kuotat e tyre në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tyre.

Kontributi i ortakëve në kapitalin themeltar është si më poshtë:

- a) z. **Kreshnik Lekaj** zotëron I kuotë me vlerë 50'000. lekë (50%);
- b) z. **Ylli Deda** zotëron I kuotë me vlerë 50'000. lekë (50%);

- 1. Ortakët e shoqërisë janë përgjegjës ndaj shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar për të gjitha detyrimet e marra përsipër dhe përgjigjen për humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.
- 2. Fondet monetare të shoqërisë mund të përdoren për zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarisë së saj ekonomiko-financiare.

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të administrohet nga z. **Kreshnik Lekaj**, shtetas shqiptar, atësia Losh, amësia Age, lindur në Lezhë dhe banues në Lezhë, me adresë Shëngjin, Ishull Lezhë, Nr. 4503, i datëlindjes 03/08/1975, gjendja civile " i martuar ", person madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftim ID nr. 036743237 dhe nr. Personal H50803024F, konform dispozitave të ligjit dhe parashikimeve të statutit të shoqërisë.

Administratori emërohet për një periudhë 5 vjecare me të drejtë rizgjedhje.

DISPOZITA KALIMTARE

Rregullat për organizimin dhe drejtimin e shoqërisë tregtare parashikohen hollësisht në Statutin e shoqërisë që shoqëron këtë akt themelimi.

Të gjitha mosmarrëveshjet me institucione publike ose private, me persona fizik dhe juridik do të

zgjidhen me mirëkuptim. Nëse nuk arrihet mirëkuptimi, çështja do të jetë në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky akt themelimi përpilohet në 5 (pesë) kopje origjinale, me vlerë të njëjtë ligjore. në gjuhën shqipe, një prej të cilave do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.


Lexuar, miratuar dhe nënshkruar.

ORTAKËT

E

Shoqërisë Tregtare “YLLI I DETIT” sh.p.k.,

Kreshnik Lekaj



Yli Deda

